

VENDIM
Nr.10, datë 20.2 2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.8,
DATË 4.2.2009 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR
KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 20.2.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për ndryshimin e afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 4.2.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”,

dhe konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.110, datë 16.9.2008, shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., është licencuar nga ERE-ja, për aktivitetin e ndërtimit, prodhimit, instalimin dhe shfrytëzimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike me erë, për një periudhë vlefshmërie prej 30 vjetësh.

- Në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, në pikën 5.2 përcaktohet një kohëzgjatje e vlefshmërisë së licencës së tregtimit të energjisë në përputhje me atë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.8, datë 4.2.2009 “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”, në pikën 1, afati prej 5 vjetësh ndryshohet dhe bëhet 30 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 4.2.2009.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta